

VENDIM
Nr.453, datë 18.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.358, DATË 28.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË
DOGANAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të doganave”, që i bashkëlidhet vendimit nr.358, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të Doganave

				PAGA MUJORE			
			EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE		SHITESA E POZICIONIT	
Kate goria		Paga e Grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kuali fikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për Kushte pune
	II-a		Drejtor i Përgjithshëm	2%		100500	15000
	II-b		Zv/drejtor i përgjithshëm	2%		84000	15000
A	III-a	1	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë. Nëpunës ndërlidhës i qendrës SECI.	2%		65000	17000
B	III-a/1	1	Përgjegjës/Shef sektori. Specialist i marrëdhënieve me publikun. Kryetar degë doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë Thanë, Elbasan. Kryehetues doganor. Shef operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës.	2%		55000	16000
C1	III-b	1	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. Specialist laborator. Përkthyes. Inspektor kontrolli. Koordinator në DOH. Shef turni. Komandant grupi antikontrabande. Doganier analize risku Aposteriori, Borxhi. Jurist. Administrator rrjeti në degë doganore.	2%		49000	14500
C2	IV-a	1	Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Llogaritar. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator.	2%		37450	14000
C3	IV-b	2	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretare. Arkivist.	2%		25850	11000
D1		2	Arkëtar. Magazinier.Furnitor. Operator. Shofer. Teknik. Shoqërues.	2%		27400	
D2		3	Centralist. Sportelist. Sanitar. Mirëmbajtës.	2%		18500	
D2		4	Pastrim mirëmbajtje	2%		16500	